



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0078642-2 A/26 dt. 11.01.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 41, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 Për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenit 48 dhe 49, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen të mbajtur më dt.11.01.2026 mori këtë:

VENDIM

Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

1. Me këtë vendim Z. Safet Kamberi zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Kryesuesi i Kuvendit, i zgjedhur sipas pikës 1 të këtij Vendimi, zgjedhet për mandatin e njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.
3. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit do të jenë siç janë paraparë me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 2009/01 Për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Mitrovicës, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe ligjet tjera në fuqi.
4. Kryesuesi i Kuvendit njëkohësisht kryeson edhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Kryesuesi i Kuvendit të komunës, paguhet në bazë të Ligjit Nr.08/L-196 Për pagat në sektorin publik.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

